



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d), nenin 17 shkronja a), s) dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën l) të Ligjit për Vetqeverisje Lokale 03/L-040. Nenit 10 nen pikën 4) dhe nenin 15 të Statutit të Komunës së Klinës, neni 7 paragrafi 1 pika 1.2 i Udhezimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2023 për administratë të hapur në komunë, me kërkesen e Drejtorisë për Financë, Ekonomi dhe Zhvillim, si dhe me rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financë të datës: 08.03.2024. Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2024 të mbajtur me 29.03.2024, mori këtë:

V E N D I M

Për

vënie në diskutim publik draft-rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa të tjera komunale

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financë, Ekonomi dhe Zhvillim për vënie në diskutim publik draft-rregulloren për taksa, tarifa dhe ngarkesa të tjera komunale.
2. Vënia në diskutim publik behët me qëllimin e dhenjës së kontributit nga të gjitha institucionët dhe qytetarët e Komunës së Klinës.
3. Përgjegjës për procesin e konsultimit publik është inicuesi për miratimin e kësaj rregulloreje, ashtu siç parashihet me udhëzimin administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në komunë.
4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës konform nenit 81 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Financë, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-11335 /24
Klinë me 03.04 /24



Kryesuesi,
Fadil Gashi